



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 154, datë 19.09.2024

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“MBI RREGULLA TË MËTEJSHME MBI INVESTIMET DHE VEPRIMTARINË E
FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 89, pika 6, të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e rregullores “Mbi rregulla të mëtejshme mbi investimet dhe veprimtarinë e fondit të pensionit privat”.**
- 2. Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve dhe Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**